



REPUBLIKA E SHqipërisë

## BASHKIA E PATOS

### PROCEDURA PËR DHËNIEN ME QIRA TË OBJEKTEVE DHE TRUALLI

Për procedurat e dhënies me qira do të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 54 dt.05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurive shtetërore” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 13 dt.26.04.2018 “Për zbatimin e vendimit të këshillit të ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.

Pasuritë shtetërore, që jepen me qira, sipas përcaktimit në pikën 1 të vendimi nr. 54 janë: 1-ndërtesat, 2-sipërfaqe funksionale (jo nën ndërtesë), 3- trualli i lirë, 4- makineritë e pajisjet, 5- linjat e prodhimit, të institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve dhe shoqërive tregtare me kapital 100 për qind shtetëror (që më poshtë do të shprehet «shoqëri shtetërore»).

-Pasuritë shtetërore, që jepen me enfiteozë sipas përcaktimit në pikën 1 të këtij vendimi janë vetëm pasuritë e paluajtshme të institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve dhe shoqërive shtetërore.

- **Bashkia përgatit dokumentacionin si më poshtë referuar Kreut II të V.K.M nr. 54 :**

1-Propozimin për dhënie me qira, i cili duhet të përmbajë propozimin për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri dhe afati i dhënies me qira.

2-Vendimin e organit drejtues të institucionit shtetëror (vendimin e kryetares).

3-Miratimin nga organi i varësisë administrative (Këshilli Bashkiak).

4-Genplanin e objektit në 6 kopje origjinale, të hartuar nga topograf me licensë dhe të konfirmuara nga institucioni shtetëror (Bashkia Patosë) ku të jenë të përcaktuara qartë sipërfaqja e truallit gjithsej, sipërfaqja nën ndërtesë dhe sipërfaqja funksionale (jo nën ndërtesë).

5-Tarifën dysHEME të detyrimit mujor për sipërfaqen nën ndërtesë sipas përcaktimit të VKM nr. 54 duke marrë parasysh dhe gjendjen fizike të objektit, vlera dysHEME për ndërtesat është 0.3 % e vlerës mesatare të shitblerjes së banesave për qytetin e Patosit.

6. Për sipërfaqen funksionale, tarifa dysHEME e qirasë mujore është 20 për qind e tarifës dysHEME të detyrimit mujor, të përcaktuar për ndërtesat. Trualli nën ndërtesë (objekti) përfshihet në tarifën e qirasë së ndërtesës.

Tarifa për qeranë e tokës së pafrytshme sipas vkm nr. 45 i referohet ligjit nr. 8752 dt.26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës” të ndryshuar, në të cilën parashikohet që tarifa dysHEME e qirasë mujore të jetë e njëjtë me ato për tokën bujqësore.

8-Konfirmim nga ZVRPP për pronësinë shtet të objektit dhe truallit, si dhe nga Agjensia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave për vendimet që mund të ketë dhënë për njohje ose kthim prone.

#### - **Objektet e përcaktuar në shkronjën ‘B dhe C’ të pikës 6 të kreut II konkretisht**

Organi që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të institucionit shtetëror etj, që jepen me qira deri në 20 vjet.

Për tokat e pafrytshme për sipërfaqe 200-500 m është deri në 10 vjet, për sipërfaqe mbi 500 m është deri në 20 vjet.

Pas përgatitjes së dokumentacionit, drejtusi i institucioni (Kryetari i Bashkisë) nxjerr urdhërin për dhënien me qira të pasurisë me konkurim.

#### **Urdhëri duhet të përmbajë:**

1.Të dhënat për pasurinë që do të jepet me qira, emërtimin, sipërfaqen, zonën kadastrale, qëllimi i përdorimit, vlera dysHEME e detyrimit mujor sipas tarifave të VKM nr. 54.

2.Veprimtarinë që mund të ushtrohen në objekt.

3.Pikët vlerësuese për elementet e konkurimit për nivelin e investimit, nivelin e punësimit, ofertën e detyrimit mujor të qirasë, të cilat përcaktohen rast pas rasti, nga titullari i institucionit.

4.Vendin dhe datën ku paraqiten dokumentet.

5.Përbërjen e komisionit të shqyrtimit të ofertave të konkurrentëve, jo me pak se 3 veta.

Njoftimi për publikim për dhënie me qira shpallet 1 herë në Buletinin e Njoftimit Publik dhe në njoftim përcaktohen të dhëna për objektin, kategorizimin e veprimtarisë që do të ushtrohet në objekt, afatin e dhënies me qira, pikët vlerësuese për elementet e konkurimit, dokumentacionin që do të paraqesin konkurrentët, si dhe vendin, datën dhe orën e paraqitjes së dokumentacionit.

Data e konkurrimit të jetë jo më pak se 7 ditë kalendarike nga data e botimit të fundit.

### **DOKUMENTACIONI QË PARAQET KONKURRENTI I DORËZOHET KOMISIONIT NË ORËN E HAPJES DHE PËRMBAN:**

1-Kërkesën e subjektit për marrje me qira, ku të deklarojë ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes me qira të pasurisë, si dhe treguesit e konkurrimit, të parashikuar në planin e biznesit.

2-Planbiznesin e hollësishëm për vënien në funksion të objektit, në të cilën duhet të përfshihet informacioni mëposhtëm;

-Identitetin e subjektit kërkues, historiku aktivitetit që kryen,

-Përshkrimin e projektit të investimit, punimeve që do të realizohen , shërbimeve që do të ofrohen , burimeve financiare të investimit,

-Analiza e detajuar e afateve kohore, që do të duhet për të realizuar projektin investues, si dhe fazat e përcaktuara të realizimit të tij,

-Nivelin e punësimit, që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara.

*Nëse kërkesa e subjektit është për një afat mbi 5 vjet , plani biznesit të jetë përshkruar hollësisht, me të dhëna për 5 vitet e para të aktivitetit dhe parashikimin për periudhën tjetër.*

3-Deklaratën në formën e vetëdeklarimit si më poshtë vijon;

-Deklaratë për të dhënat e NIPT/NUIS të subjektit kërkues,

-Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore,

-Deklaratë për administratorin dhe subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale dhe nëse ka një proces gjyqësor në lidhje me aktivitetin,

-Në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira në objekte pronë shtetërore, deklaratë për shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt të deklaroj se nuk ushtron aktivitet në objekt shtetëror,

-Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorzuar në konkurrim. Në rast të konstatimit të të dhënave të rreme komisioni e s’kualifikon subjektin konkurrues.

### **KOMISIONI I DHËNIES ME QIRA TË PASURISË SHTETËRORE KRYEN KËTO DETYRA:**

-Merr në dorëzim zarfin e mbyllur të konkurrentëve pjesëmarrës dhe e hap në prani të tyre , i lexon dhe u bënë të njohur të dhënat kryesore të dokumentave dhe treguesve konkurrues për cdo ofertë të paraqitur, kur dokumentacioni nuk është i plotë konkurenti nuk kualifikohet në prani të tij,

-Harton procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit, ku përshkruhen pjesëmarrsitë, konkurrentët e skualifikuar dhe shkakun, konkurrentët e kualifikuar dhe listën e dokumentave të paraqitur prej tyre.

-Brënda 15 ditësh bënë shqyrtimi e ofertave të paraqitura, verifikon dokumentacionin e paraqitur nepërmjet platformëa elektronike *e-Albania* ose nepërmjet konkurrimit e ndërveprimit ndërinstytucional, sipas përcaktimit në Urdhërin e titullarit dhe vleron me pikët maksimale të cdo elementi konkurrues, ndërsa subjekteve të tjera pikët u llogariten në përpjestim të drejtë me vlerën më të lartë të propozuar. Në përfundim, konkurrusit renditen në bazë të shumës së pikëve të përfituara.

Në rast se rezultojnë të dhëna të ndryshme nga të dhënat e dokumentacionit të paraqitur në formën e vetëdeklarimit në konkurrim automatikisht subjekti s'kualifikohet, duke vazhduar me atë që është renditur i dyti.

**Metodologjia e vlerësimit të kriterëve të konkurrimit parashikohet në udhëzimin nr. 13 dt.26.04.2018 për zbatimin e vendimit të këshillit të ministrave nr. 54 dt.05.04.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurive shtetore” i ndryshuar.**

*Titullari i institucionit që ka të drejtën për lidhjen e kontratës vendos për subjektin fitues në konkurrim.*

Nëse në konkurrim marrin pjesë shumë konkurrues, njoftimi i fituesit vendoset në këndin e njoftimeve të instituconit përkatës.

Subjektet konkurrues brenda 5 ditëve pune nga shpallja e njoftimit të fituesit, e ankimon te titullari i institucionit, i cili brenda 10 ditëve duhet ti kthej përgjigje me shkrim ankuesit. Mbas kësaj procedure vazhdohet me lidhjen e kontratës.

Para nënshkrimit të kontratës së qirasë bëhet pagesa e garancisë së kontratës e cila është e barabartë sa vlera e tre muajve të pagesës së kontratës.

**Sqarim: Nëse pagesa bëhet vjetor atëher supozohet që është bërë edhe sigurimi i kontratës, nëse bëhët muaj për muaj duhet sigurimi i kontratës.**

#### **NXITJA E BIZNESIT**

Për objektet e dhëna me qira me sipërfaqe mbi 200 m<sup>2</sup> vlera e detyrimit mujor llogaritet në zbritje, kur subjekti që ka marrë me qira vërteton, nepërmjet ekspertit kontabël të miratuar që në llogaritë financiare vjetore të tij se ka investuar në pasurin e marrë me qira për përmirësimin e saj, si dhe për bërjen e instalim linjash, makineri e pajisjesh me vlerat si më poshtë;

-investime mbi 50 milion lekë, zbritje 10 përqind

-investim mbi 80 milionë lekë, zbritje 20 përqind

-investim mbi 100 milion lekë, zbritje 30 përqind

-investim mbi 150 milion lekë, zbritje 40 përqind



REPUBLIKA E SHqipërisë

**BASHKIA PATOS**

**I. PROCEDURA PËR DHËNIEN ME QIRA TË TOKAVE BUJQËSORE TË PANDARA (Jepen nga Bashkitë)**

**II. PROCEDURA PËR DHËNIEN ME QIRA TË TOKËS BUJQËSORE E PYJORE, TË LIVADHEVE DHE KULLOTAVE QË JANË PASURI SHETETRORE ( Jepen me qira nga Ministria e Bujqësisë)**

**I- Për dhënie me qira të tokave bujqësore të pandara zbatohet ligji nr. 8312 datë 26.03.1998, VKM nr. 531 dt.21.08.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, Udhëzim nr. 1 dt. 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” i ndryshuar.**

**Objekt për dhënie me qira sipas Udhëzimit nr. 1 (Bashkia Qiradhënëse) janë:**

- a) Sipërfaqet e tokave të dhëna në pronësi të ish-komunave , sot Nj.Administrative ose Bashkive, të regjistruara në regjistrat kadastralë në kategorinë e resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullot apo livadhe, si dhe sipërfaqet e tokave të pafrytshme të cilat më pas kanë kaluar në kategorinë e resursit bujqësor sipas procedurave të ligjit nr. 8751 dt.26.03.2001.

Kryetari i Bashkisë ku ndodhet toka bujqësore, në cilësinë e autoritetit qiradhënëse, krijon Komisionin e qiradhënies së Tokës Bujqësore të Pandarë (KQTBP) komisioni ka në përbërje:

- |   |          |
|---|----------|
| 1-Kryetari i Bashkisë                                 | kryetar; |
| 2-Një përfaqësues të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë | anëtar;  |
| 3-Një përfaqësues të DAMT-së në qark                  | anëtar;  |
| 4-Një specialist të ZMMT-së në Bashki                 | anëtar;  |
| 5-Një specialist jurist në Bashki                     | anëtar;  |

**Kryetari i Bashkisë në cilësinë e autoritetit qiradhënëse, ka për detyrë:**

- shqyrtimin e kërkesave të paraqitura nga subjektet për marrjen me qira,
- organizimin e procedurës së garës,
- shpalljen dhe njoftimin e vendimit të marrë për qiradhënien pranë Bashkisë
- lidhjen e kontratës tip me subjektin e përzgjedhur,
- verifikimin e respektimit të kushteve të përcaktuara në kontratën tip gjatë të gjithë kohëzgjatjes së saj.

Kërkesë për marrje me qira mund të paraqesi cdo person, fizik dhe juridik , vendas ose i huaj.

Tokat bujqësore jepen me qira vetëm për shfrytëzim të saj për veprimtari bujqësore.

### **PROCEDURAT QË NDIQET NGA “KQTBP” PËR DHËNIEN ME QIRA ËSHTË:**

Subjekti i interesuar paraqet kërkesë me shkrim drejtuar Kryetarit të Bashkisë, ku të përfshihen:

-të dhënat e kërkuarit

-sipërfaqja dhe vendndodhja e tokës bujqësore, e cila kërkohet të merret me qira, e identifikuar me numrat kadastralë përkatës, të reflektuar në dokumentacionin e DAMT-së së qarkut ose me numrin e pasurisë të reflektuar në dokumentacionin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme (ZVRPP); - afati i qirasë;

- veprimtaria bujqësore që do të zhvillohet mbi tokën e marrë me qira, duke përcaktuar kulturat bujqësore ose speciet e bimëve me të cilat lidhet kjo veprimtari;

- aspektet kryesore të teknologjisë që do të aplikohet në kultivimin e bimëve, si dhe përpunimin e produkteve; - investimet kryesore mbi infrastrukturën (kullim, ujitje, sistemimin etj.), të shprehura në tregues, fizikë dhe monetarë, si dhe investimet e lidhura me mbjelljen e kultivimin e bimëve dhe me përpunimin e produkteve etj.;

- burimet e financimit që garantojnë investimin, të shprehura në vlerë monetare; - ndikimin e investimit në rritjen e numrit të të punësuarve në komunën ose bashkinë përkatëse; - propozimin për çmimin e ofruar për marrjen e tokës bujqësore me qira (lekë/ha në vit).

-Kërkesës i bashkëlidhet vërtetimi i lëshuar nga DAMT-ja e qarkut, ku tregohet kategoria e resursit të tokës bujqësore, siç rezulton në dokumentacionin kadastral, si dhe jepet informacioni për gjendjen e pronësisë së saj.

-Gjithashtu, kërkesës i bashkëlidhet një plan i hollësishëm i zhvillimit të biznesit.

- Me marrjen e kërkesës së parë për qiramarrje të tokës bujqësore, kryetari i bashkisë menjëherë fton me shpallje publike pranë bashkisë, të interesuarit të

depozitajnë kërkesat e tyre për marrjen me qira të së njëjtës tokë bujqësore, brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh nga data e shpalljes.

Kryetari i Bashkisë, në të njëjtën shpallje, njofton edhe datën, vendin dhe orën e zhvillimit të procedurës së garës, e cila duhet të kryhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të afatit 10-ditor për paraqitjen e kërkesave.

Me kalimin e afatit 10-ditor të paraqitjes së kërkesë-ofertave, kryetari i bashkisë thërret mbledhjen e KQTBP-së me pjesëmarrjen e plotë të të gjithë anëtarëve të tij, në datën e caktuar për zhvillimin e garës. Çdo anëtar i komisionit është i detyruar të paraqitet në mbledhjen e KQTBP-së sipas njoftimit. KQTBP-ja, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të afatit të paraqitjes së kërkesave, duhet të vlerësojë kërkesat dhe të marrë vendimin përkatës.

Pas përfundimit të afatit 30 ditor, është paraqitur vetëm një kërkesë për marrje me qira të tokës bujqësore, atëherë KQTBP-ja e shqyrton atë në datën e përcaktuar për garën dhe merr vendimin përkatës.

#### **KQTBP-JA I VLERËSON KËRKESË-OFERTAT E PARAQITURA BAZUAR NË KRITERET E MËPOSHTME:**

- a) Teknologjinë që do të aplikohet në kultivimin e bimëve, si dhe në përpunimin e produkteve;
- b) Investimet kryesore mbi infrastrukturën (kullim, ujitje, sistemimin etj.), të shprehura në tregues, fizikë dhe monetarë, si dhe investimet e lidhura me mbjelljen e kultivimin e bimëve dhe me përpunimin e produkteve etj.;
- c) Ndikimin e investimit në rritjen e numrit të të punësuarve në komunën ose bashkinë përkatëse;
- ç) Propozimin për çmimin e ofruar për marrjen e tokës bujqësore me qira (lekë/ha në vit).

Mënyra e përlllogaritjes së kriterëve të vlerësimit të kërkesë-ofertave për marrjen me qira të tokës bujqësore, përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Vendimi i KQTBP-së për dhënien me qira të tokës bujqësore është i vlefshëm kur për të votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve të komisionit. Vendimi i KQTBP-së përgatitet me shkrim dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e tij. Vendimi përmban klasifikimin dhe pikët e të gjitha kërkesave të shqyrtuara së bashku me arsyetimet përkatëse, si dhe evidenton kërkesën fituese. Vendimi shpallet menjëherë pranë bashkisë, si dhe u njoftohet subjekteve pjesëmarrëse.

- Çmimi dysheme i dhënies së tokës bujqësore me qira, si në rastin e paraqitjes së një kërkesë, ashtu dhe në rastin e paraqitjes së dy ose më shumë kërkesave për të

*njëitën sipërfaqe, nuk mund të jetë më i ulët se 6 000 (gjashtë mijë) lekë/ha, në një vit kalendarik.*

Çdo subjekt, i cili ka paraqitur kërkesë për marrje toke bujqësore me qira, ka të drejtë të ankohet për vendimin e KQTBP-së te Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

Ministri shqyrton ankimimin e subjektit të interesuar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së tij dhe, kur e vlerëson të drejtë, urdhëron kryetarin e bashkisë për ripërsëritjen e procedurave të shqyrtimit të kërkesave nga KQTBP-ja, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së urdhrimit.

Kundër vendimit të KQTBP-së në lidhje me kërkesën për marrje toke me qira, objekt i shkronjës (a) kreut I, bëhet ankim pranë gjykatës së rrethit gjyqësor ku ndodhet toka, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

Pas mbarimit të afateve të ankimit 10 ditor, bazuar në vendimin e KQTBP-së, lidhet kontrata tip e qirasë ndërmjet kryetarit të bashkisë, në cilësinë e autoritetit qiradhënës, dhe subjektit të përzgjedhur, në cilësinë e qiramarrësit.

### **III. PROCEDURAT QË NDIQEN NË RASTET KUR FUNKSIONET E AUTORITETIT QIRADHËNËS USHTROHEN NGA “MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT”.**

- a. Tokat bujqësore , të cilat në dt.1.8.1991 janë të regjistruara si të tilla në regjistrat kadastral, si dhe kanë qënë në përbërje të ish-koperativave bujqësore dhe kanë ngelur pa u ndarë sipas ligjit nr. 7501 dhe ligjit nr. 8312 , për shkak të refuzimit të marrjes së tyre në pronësi nga familjet bujqësore.

Në rastin kur kryetari i bashkisë nuk ndërmerr veprimet e parashikuara me lart sipas udhëzimi nr.1 **“Pra nuk ka të drejtë të jap me qira vete”**, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e regjistrimit të kërkesës, funksionet e autoritetit qiradhënies i ushtron Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, nëpërmjet strukturave në varësi të tij, vetëm për sipërfaqet, objekt i shkronjës “a” të kreut II.

-Subjekti i interesuar për marrjen me qira të tokës bujqësore e shpreh interesin e tij nëpërmjet një kërkesë me shkrim që i drejtohet Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Kërkesa është si në rastin kur Bashkia është institucioni Qiradhënës.

-Kërkesa e subjektit të interesuar i kalon për shqyrtim Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë (DRB), në juridiksionin e së cilës ndodhet toka bujqësore, objekt i kërkesës, me anë të urdhrimit të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i cili ngarkon DRB-në me realizimin e procedurave të dhënies së tokës me qira.



- Drejtori i DRB-së, në zbatim të urdhrit të ministrit, krijon një grup pune prej tre specialistësh të DRB-së dhe një përfaqësues nga DAMT-ja e qarkut, i cili, nën drejtimin e drejtorit të DRB-së, ndërmer veprimet e mëposhtme:

a) Verifikon dhe saktëson në DAMT-në e qarkut të dhënat për pronësinë e tokës bujqësore të kërkuar për qiradhënie, si dhe madhësinë e sipërfaqes së saj sipas numrave kadastralë;

b) Në zbatim të procedurave dhe afateve të parashikuara me lartë (**sipas udhëzimi nr.1**) shqyrton dhe vlerëson kërkesat e paraqitura nga subjektet e interesuara. Shpalljet dhe njoftimet publike bëhen pranë DRB-së;

c) Pas përfundimit të shqyrtimit të kërkesave nga grupi i punës, drejtori merr vendimin, i cili përmban klasifikimin dhe pikët e të gjitha kërkesave të shqyrtuara, si dhe evidenton kërkesën fituese për dhënie të tokës bujqësore me qira.

Vendimi i dërgohet menjëherë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe u njoftohet subjekteve pjesëmarrëse në garë.

Çdo subjekt, i cili ka paraqitur kërkesë për qiramarrje të tokës bujqësore, ka të drejtë të ankohet në lidhje me procedurat e zhvillimit të konkursit pranë ministrit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të drejtorit të DRB-së.

Në bazë të urdhrit të ministrit, drejtori i DRB-së, në cilësinë e personit të autorizuar nga autoriteti qiradhënës, lidh kontratën për dhënie të tokës bujqësore me subjektin e përzgjedhur, në cilësinë e qiramarrësit.

Një kopje e kontratës së lidhur i dërgohet kryetarit bashkisë në juridiksionin e të cilit ndodhet toka, objekt i kontratës së qirasë.

**-AFATET E DHËNIES ME QIRA TË TOKAVE BUJQËSORE TË PANDARA DHE SIPËRFAQET PËRKATËSE TOKAT BUJQËSORE TË PANDARA JEPEN ME QIRA PËR AFATE KOHORE, SI MË POSHTË VIJON:**

a) Deri në 10 (dhjetë) vjet, kur destinohen për kultivim të bimëve të arave, eterovajore dhe bimëve dekorative. Në këtë rast, madhësia e sipërfaqes së tokës bujqësore që jepet me qira nuk mund të jetë më e vogël se madhësia e sipërfaqes së parcelës, sipas së cilës rezulton e regjistruar në dokumentacionin kadastral të DAMT-së, ose sa madhësia e sipërfaqes së parcelës, sipas së cilës ajo reflektohet në hartën treguese të tokës “HTR”, pranë ZVRPP-së.

b) Deri në 35 (tridhjetë e pesë) vjet, kur destinohen:

i) për krijimin dhe kultivimin e vreshtave;

ii) për krijim pemëtoresh me specie dru frutorë, mosha biologjike e të cilëve përkon me këtë kohëzgjatje kultivimi dhe me rentabilitet ekonomik;

iii) për ndërtim serrash e kultivim të bimëve në to;

iv) për fidanishte.

Në këtë rast, madhësia e sipërfaqes që jepet me qira, nuk mund të jetë më e vogël se **0.5 ha**.

c) Deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet, kur destinohen:

i) për krijim ullishteje;

ii) për krijim pemëtoreje me dru frutorë, si kulturat arnore dhe specie të tjera, mosha biologjike e të cilave përkon me këtë kohëzgjatje.

Në këtë rast, madhësia e sipërfaqes që jepet me qira, nuk mund të jetë më e vogël **se 1 ha.**